



Regresi i drejtësisë civile

(Raport i monitorimit të rasteve gjyqësore civile gjatë vitit 2021)



2024

Autorë: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Redaktor: Gzim Shala

Me kontribut të: Driton Nocaj dhe Blerta Barku

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD


IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Shtator, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Monitorimi i drejtësisë civile.....	5
3. Rekordi i lëndëve të pazgjidhura	5
4. Ngarkesa e sistemit të drejtësisë nga keqadministrimi i institucioneve	7
5. Efikasiteti i gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve civile	8
6. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore	9
7. Trajtimi selektiv i rasteve gjyqësore.....	10
8. Shpërndarja jo-proporcionale e gjyqtarëve.....	11
9. Kundërligjshmëria dhe mos uniformiteti i vendimeve lidhur me tërheqjen e padisë.....	11

1. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2021 ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve kontestimore të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. Përderisa Gjykatat Themelore e kanë filluar vitin 2021 me 64.628 lëndë të pazgjidhura, ky vit është mbyllur me gjithsej 85.087 lëndë të pazgjidhura të cilat janë bartur në vitin pasues. Në vitin 2018, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit ka qenë 44.213. Kështu, që nga ajo kohë, tanimë numri i lëndëve të pazgjidhura pothuajse është dyfishuar.

Faktori kryesor i ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura është rritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar. Shkaktari kryesor i ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar dhe rëndimi kaq i madh i sistemit gjyqësor konsiderohet të jetë administrimi jo adekuat i institucioneve të cilat janë të obliguara të përmbushin detyrimet sipas Kontratave Kolektive. Mos zbatimi i obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive nga ana e institucioneve administrative ka bërë që të drejtat që rrjedhin nga këto kontrata të fitohen vetëm përmes rrugëve gjyqësore. Kjo qasje ka rënduar tejmasë gjendjen e sistemit të drejtësisë.

Në vitin 2018, sistemi gjyqësor ka pranuar gjithsej 19609 raste civile derisa në vitin 2021 janë pranuar 43.536 lëndë të kësaj natyre. Rreth 40% e lëndëve të pranuar, janë lëndë të cilat kanë të bëjnë me obligimet sipas kontratave kolektive. Kjo i bie se vetëm gjatë vitit 2021, rreth 17.400 lëndë civile janë lëndë të cilat rrjedhin nga kontestet që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve përkitazi me kontratën kolektive. Përpos rëndesës së sistemit gjyqësor, ky mos veprim nga ana e institucioneve administrative dëmton edhe buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo pasi nëse këto institucione do të zbatonin obligimet sipas kontratës kolektive dhe nuk do të kërkohej ndjekja e rrugëve ligjore, kompensimi ndaj të punësuarve kufizohet deri në të drejtën e të punësuarit e cila i takon sipas kontratës kolektive. Por, në rastet kur realizimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet rrugëve gjyqësore, atëherë krijohen edhe shpenzimet procedurale, që në disa raste dinë të jenë më të larta se sa vet e drejta që kërkohet.

Nëse marrim si pikë reference numrin e lëndëve të cilët gjyqtarët obligohen ti zgjidhin brenda një viti, atëherë del se rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura i ka kontribuar edhe mos efikasiteti i gjyqtarëve. Kjo pasi në mesataren e përgjithshme, gjyqtarët nuk kanë arritur që të zgjidhin lëndë aq sa kërkohet sipas normës orientuese.

Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile vazhdon të jetë një prej problematikave kryesore. Sipas të dhënave të KGJK, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile nga paraqitja e padisë e deri në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit nga ana e Gjykatës së Apelit është 5.4 vite. Përballë kësaj kohëzgjatje të përgjithshme, IKD ka evidentuar edhe trajtim selektiv të rasteve civile. Kjo pasi IKD ka evidentuar raste, kohëzgjatja e trajtimit të të cilave ka qenë mbi 15 vite derisa në anën tjetër janë evidentuar edhe raste kur kohëzgjatja e trajtimit ka qenë 2.4 vite.

Si një prej aspekteve problematike të administrimit të drejtësisë, IKD ka gjetur se është edhe shpërndarja jo-proporcionale e gjyqtarëve, e cila duhet të adresohet nga KGJK. Po ashtu, ky raport ka gjetur edhe jo uniformitet të praktikës gjyqësore në rastet kur paditë konsiderohen të tërhequra, e cila situatë duhet të adresohet nga ana e Gjykatës Supreme.

2. Monitorimi i drejtësisë civile

Ky raport është rezultat i monitorimit të drejtë për drejtë që Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) i ka bërë drejtësisë civile në Kosovë. Gjatë vitit 2021, IKD ka monitoruar gjithsej 1,166 seanca gjyqësore të natyrës civile. 911 prej këtyre seancave janë mbajtur derisa 255 të tjera janë shtyrë. Shprehur në përqindje, i bie se 78.1% e seancave gjyqësore civile janë mbajtur derisa 21.8% e tyre janë shtyrë. Sipas këtyre të dhënave, del se çdo e pesta seancë civile është shtyrë.

Mungesa e paditësit del të jetë arsyeja më e madhe e shtyrjes së seancave gjyqësore (107 raste), pasuar nga mungesa e të paditurit (84 raste). Por, në jo pak raste, edhe vet gjyqtarët kanë qenë arsyeja pse seancat gjyqësore në rastet civile janë shtyrë. Gjatë monitorimit, IKD ka evidentuar gjithsej 63 seanca gjyqësore ku për shkak të mungesës së gjyqtarit është shtyrë seanca gjyqësore. Kështu, shprehur në përqindje, në 24.7% të rasteve kur seancat gjyqësore shtyhen, shkak i kësaj janë vet gjyqtarët. 2 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të tjera.

3. Rekordi i lëndëve të pazgjidhura

Ngarkesa e madhe e divizioneve civile konsiderohet si një prej problemeve kryesore në këtë fushë. Kjo ngarkesë konsiderohet, mbi të gjitha, si shkak i trajtimit të lëndëve civile jashtë afatit të arsyeshëm kohor. Supozohet se një ngarkesë e madhe me lëndë civile ndikon edhe në cilësinë e vendimeve civile të nxjerra nga gjykatat.

Viti 2021 ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. Përderisa GjTh e kanë filluar vitin 2021 me 64.628 lëndë të pazgjidhura, ky vit është përmbyllur me gjithsej 85.087 lëndë të pazgjidhura të cilat janë bartur në vitin pasues¹.


Përkundër faktit se ngarkesa me lëndë civile konsiderohet si një prej problemeve kryesore të drejtësisë civile në Kosovë, kjo ngarkesë është rritur vit pas viti. Vetëm gjatë vitit 2021, kjo ngarkesë është rritur për 20,459 lëndë, që paraqet afërsisht një të tretën e numrit të lëndëve me të cilat sistemi gjyqësor e ka filluar vitin 2021.

Nëse e shohim kronologjikisht, që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2021², numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur në vazhdimësi, duke rënduar gjendjen e divizioneve civile sa i përket

¹ “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor- 2021”. Prishtinë. 2022. Fq.7. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 27 qershor 2022).

² Po aty; “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor - 2020”. Prishtinë. 2020. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/23323_KGJK_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2010_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 27 qershor 2022).; “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor- 2019”. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/37650_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2019_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 27 qershor 2022).; “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor- 2018”. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/37650_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2019_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 27 qershor 2022).;

ngarkesës me lëndë. Që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2021, numri i rasteve të pazgjidhura pothuajse është dyfishuar:



Grafika 1: Trendi i numrit të lëndëve të pazgjidhura në vitet 2018-2021.


Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës (2014-2019) përcaktonte se “Lëndët e grumbulluara në sistemin gjyqësor duhet të eliminohen dhe duhet të miratohen procedura për t’iu shmangur grumbullimit të lëndëve në të ardhmen”³. Këtë objektiv e përmban edhe Plani Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës (2020-2022)⁴. Përkundër përcaktimit të këtyre objektivave, të dhënat flasin për rezultat të kundërt. Kjo pasi përballë synimit që numri i lëndëve të pazgjidhura të ulet, ky numër tanimë pothuajse është dyfishuar.

Ngritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura shfaqet në rastet kur gjykatat nuk arrijnë që brenda një viti të zgjidhin lëndë aq sa kanë pranuar. Gjatë vitit 2021, gjykatat kanë pranuar gjithsej 43,536 lëndë civile derisa kanë zgjidhur 23,077 lëndë të kësaj natyre. Kështu, gjatë vitit 2021, gjykatat kanë zgjidhur 20,459 lëndë më pak se sa që kanë pranuar. Ky numër i lëndëve më pastaj shndërrohet në ngritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të një periudhe raportuese, në rastin konkret të vitit 2021.

Krahas nivelit të efikasitetit të gjyqtarëve dhe resurseve të gjykatave për të trajtuar rastet civile, në analizimin e trajektoret së ngritjes së lëndëve të pazgjidhura domosdoshmërisht se ndikon edhe trendi i numrit të lëndëve të pranuar. Ky trend duket se ka qenë edhe njëri prej shkaktarëve të ngritjes kaq të lartë të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Kjo pasi që nga viti 2018 e tutje, numri i lëndëve të pranuar vazhdimisht është rritur. Më saktësisht, në vitin 2021, numri i lëndëve të pranuar ka qenë më shumë se dyshim më i lartë se sa në vitin 2018.

³ “Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019”. Prishtinë. Fq.19. (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2019/03/Plani-Strategjik-2014-2019-ALB.pdf> f.35. (Qasur për herë të fundit më 27 qershor 2022).

⁴ “Plani Strategjik për Këshillin Gjyqësor 2020-2022”. Prishtinë. Fq.5,10. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2020/02/KGJK_Plani_strategjik_per_Gjyqesorin_Kosoves_2020-2022-1.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 Shtator 2022).



Grafika 2: Trendi i numrit të lëndëve të pranuar në vitet 2018-2021.

4. Ngarkesa e sistemit të drejtësisë nga keqadministrimi i institucioneve

Siç u tha edhe më lartë, që nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2021, numri i lëndëve të pazgjydhura civile është ngritur vazhdimisht. Kjo ngritje në njëfarë forme ia ka humbur edhe kuptimin synimit për uljen e numrit të lëndëve të pazgjydhura. Sipas analizës së dhënë në kapitullin paraprak, del se faktori kryesor i ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjydhura është rritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar.

Shkaktari kryesor i ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar dhe rëndimi kaq i madh i sistemit gjyqësor konsiderohet të jetë administrimi jo adekuat i institucioneve të cilat janë të obliguara të përmbushin detyrimet sipas Kontratave Kolektive. Në vitin 2017, ishte nënshkruar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë. Ndër të tjera, në nenin 35, në pikën 7 dhe 8 të kësaj kontrate parashihet që të punësuarve të iu sigurohet shujta gjatë orarit të punës dhe kompensimi i shpërblimit jubilar sipas vlerës së përcaktuar në këtë kontratë. Kontrata kolektive janë nënshkruar edhe për sektorë të tjerë të të punësuarve.

Përkundër kësaj, kryesisht, obligimet e përcaktuara në kontrata kolektive janë zbatuar përmes vendimeve gjyqësore⁵. Kjo pasi institucionet administrative nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ndaj punonjësve. Si rrjedhojë, këta të fundit janë obliguar që për realizimin e të drejtave të tyre që rrjedhin nga kontrata kolektive, ti drejtohen gjyqësorit. Ky mos veprim i institucioneve administrative në raport me obligimet e tyre sipas kontratave kolektive ka rënduar tejmasë gjyqësorin dhe ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2018, sistemi gjyqësor ka pranuar (*shih grafikën 2*) gjithsej 19.609 raste civile derisa në vitin 2021 janë pranuar 43.536 lëndë të kësaj natyre. Rreth 40% e lëndëve të pranuar, janë lëndë të kësaj natyre⁶. Kjo i bie se vetëm gjatë vitit 2021, rreth 17.400 lëndë civile janë lëndë të cilat rrjedhin nga kontestet që ndërliken me zbatimin e obligimeve përkitazi me kontratën

⁵ “Zbatimi i Kontratës Kolektive të Arsimit përmes vendimeve gjyqësore”. Betimi për Drejtësi, 25 Shtator 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zbatimi-i-kontrates-kolektive-te-arsimit-permes-vendimeve-gjyqesore>). (Qasur për herë të fundit më 5 Shtator 2022).

⁶ Intervistë me Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në KGJK, 31 gusht 2022.

kolektive. Pra, sipas këtyre të dhënave, gjatë vitit 2021, numri i rasteve të kësaj natyre që janë deponuar në gjyqësor paraqet mbi 88% të numrit të të gjitha rasteve civile që gjyqësori ka pranuar në vitin 2018. Përpos GjTh-ve, këto raste kanë dëmtuar edhe efikasiten e Gjykatën së Apelit⁷.

Në anën tjetër, institucionet e administratës publike duke mos respektuar obligimet e tyre që kanë sipas kontratave kolektive, janë duke i shkaktuar konsiderueshëm dëm buxhetit të Republikës së Kosovës. Kjo pasi nëse këto institucione do të zbatonin obligimet sipas kontratës kolektive dhe nuk do të kërkohej ndjekja e rrugëve ligjore, kompensimi ndaj punëtorëve kufizohet deri në të drejtën e punëtorit e cila i takon sipas kontratës kolektive. Por, në rastet realizimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet rrugëve gjyqësore, atëherë krijohen edhe shpenzimet e procedurës, që në disa raste dinë të jenë më të larta se sa vet e drejta që kërkohej.

Për këto arsye, institucionet administrative kërkohej që të realizojnë të drejtat e punëtorëve të cilat rrjedhin nga kontratat kolektive, në mënyrë që mos të ngarkohet gjyqësori deri në këtë masë si dhe mos të dëmtohet pa nevojë buxheti i Republikës së Kosovës.

5. Efikasiteti i gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve civile

Nëse marrim si pikë reference numrin e lëndëve të cilat gjyqtarët obligohen ti zgjidhin sipas Normës Orientuese të miratuar nga KGJK, atëherë del se ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura, krahas ngritjes eksponenciale të numrit të lëndëve të pranuar, i ka kontribuar edhe mos efikasi i gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2021, numri i gjyqtarëve të cilët kanë zgjidhur lëndë kontestimore ka qenë 108. Ndërsa, gjatë këtij viti, numri i lëndëve të zgjidhura kontestimore ka qenë gjithsej 23.077. Kjo i bie se në mesatare, secili gjyqtarë brenda një viti ka zgjidhur nga 213.6 lëndë në vit derisa sipas Rregullores së miratuar nga KGJK, secili gjyqtar është i obliguar që të zgjidh nga 329 lëndë brenda vitit.

Në këtë mënyrë, në mesatare, gjyqtarët kanë zgjidhur 115 lëndë më pak se sa obligimi i tyre i përcaktuar nga KGJK. Në totalin e gjyqtarëve që kanë qenë të angazhuar në trajtimin e këtyre rasteve, kjo diferencë përbën 12.420 lëndë më pak të zgjidhura.

Në këtë mënyrë, IKD gjen se përpos aspektit të ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar si pasojë e administrimit jo të mirë të institucioneve administrative, rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura i ka kontribuar edhe mos efikasiteti i gjyqtarëve. Kjo pasi në mesatare gjyqtarët kanë arritur vetëm rreth 2/3 e normës së tyre orientuese.

Kur të shikohet aspekti i ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar, rreth 40% e të cilave kanë të bëjnë me obligime që rrjedhin nga kontrata kolektive, atëherë mos arritja e normës nga ana

⁷ “Totaj: Kemi rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën e Apelit”. Betimi për Drejtësi. 11 Qershor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/totaj-kemi-rritje-te-numrit-te-lendeve-te-pazgjidhura-ne-gjykatën-e-apelit/>). (Qasur për herë të fundit më 5 Shtator 2022).

e gjyqtarëve del të jetë edhe më problematike. Kjo pasi IKD gjatë monitorimit ka parë se lëndët të cilat derivojnë nga obligimet e përcaktuara në kontrata kolektive parimisht janë lëndë pa pengesa të theksuara procedurale dhe lehtë të menaxhueshme. Kështu, kjo i bie se edhe në këtë ngarkesë të lëndëve, rreth 40% e të cilave konsiderohen jo të rënda, gjyqtarët nuk kanë arritur që të përmbushin normën e tyre orientuese.

6. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2021 ka nënvizuar se “[a]dministrimi i përgjithshëm i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadaltë, joefikas”⁸. Në kuptim të administrimit të drejtësisë, veçanërisht në fushën e drejtësisë civile, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore ka qenë njëra ndër sfidat kryesore në administrimit e drejtësisë.

Njëri ndër dokumentet e prodhuara nga procesi i Rishikimit Funklsional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL) nënvizon se *“Afatet e arsyeshme janë paraparë edhe në Ligjin e Procedurës Civile. Sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykatat kanë një muaj afat për mbajtjen e seancës paraprake, dhe një tjetër muaj që të mbajnë shqyrtimet kryesore. Nëse dikush bën kalkulimin e hapave të ndryshme procedurale, lëndët civile duhet të trajtohet brenda dy deri në tre muajve nga data në të cilën është dorëzuar në Gjykatë”*⁹.

Por, sipas llogaritjeve të KGJK, të bëra në bazë të një formule të Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (CEPEJ), mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura vetëm në shkallë të parë është 1.261 ditë. Kjo i bie se për të marrë epilog një lëndë civile, vetëm në shkallë të parë, qytetarët duhet të presin gjithsej 3.4 vite¹⁰. Sipas të njëjtës formulë, mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve nga Gjykata e Apelit është 681 ditë apo 1.86 vite. Kështu, në total, kohëzgjatja e një lëndë civile nga momenti i parashtrimit në gjykatë e deri në momentin kur e njëjta përfundon në Gjykatën e Apelit është gjithsej 5.3 vite. Në rastet kur lëndët kthehen në rigjykim, kjo kohëzgjatje bëhet edhe më shqetësuese.

Në këtë mënyrë, mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes së lëndëve gjyqësore qartazi flet për një trajtim të lëndëve gjyqësore civile brenda një afati jo të arsyeshëm kohor. Në këtë drejtim, IKD ka gjetur se kanë ndikuar shumë faktorë, duke nisur nga keqadministrimi i institucioneve administrative dhe performanca e gjyqtarëve, të cilat u sqaruan më lartë, e edhe administrimi jo adekuat i drejtësisë, siç do të elaborohet më poshtë. Nisur edhe nga ngritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pazgjidhura, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore duket se do të vazhdojë të mbetet një prej problemeve kryesore në fushën e drejtësisë civile në Kosovë.

⁸“Commission Staff Working Document Kosovo 2021.Report”.Fq.4.(Shih linkun:https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ec34a067-8477-4adc-a123054b7d62abc4_en?filename=Kosovo%202021%20report.PDF).(Qasur për herë të fundit më 5 Shtator 2022).

⁹ “Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial”. Rishikimi Funklsional i Sektorit të Zbatimit të Ligjit në Kosovë. Qershor 2019. Fq.14.

¹⁰“Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor-2021”. Prishtinë. 2022. Fq.7. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf). (Qasur për herë të fundit me 5 shtator 2022).

7. Trajtimi selektiv i rasteve gjyqësore

Siç u tha, trajtimi brenda një afati jo të arsyeshëm kohor të lëndëve civile në sistemin e drejtësisë është një dukuri e përgjithshme e këtij sistemi. Nga kjo dukuri pësojnë të gjitha qytetarët. Përballë këtij mos efikasiteti, IKD gjatë monitorimit ka evidentuar raste të cilat as për së afërmi nuk përkojnë me kohëzgjatjen mesatare të trajtimit të rasteve civile.

Siç u trajtua në kapitullin paraprak, mesatarja e përgjithshme e trajtimit të rasteve civile nga data e paraqitjes së padisë dhe deri në momentin e vendosjes nga ana e Gjykatës së Apelit është 5.3 vite. Por, IKD ka evidentuar një rast kur nga data e paraqitjes së padisë e deri në nxjerrjen e vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit kanë kaluar gjithsej 14.2 vite. Në këtë rast, IKD ka evidentuar tejkalim të mesatares së përgjithshme të vendimmarrjes si në rastin e Gjykatës Themelore ashtu edhe në rastin e Gjykatës së Apelit. Përkatësisht, Gjykatës Themelore në këtë rast i janë nevojitur gjithsej 10.8 vite për të vendosur në këtë rast derisa Gjykatës së Apelit i janë nevojitur gjithsej 3.3 vite¹¹. Në një rast tjetër, kohëzgjatja e trajtimit të lëndës civile ka qenë plot 15.8 vite. Në këtë rast, Gjykatës së shkallës së parë për vendimmarrje i janë nevojitur gjithsej 12.41 vite ndërsa asaj të Apelit 3.46 vite¹².

Në të kundërtën e kësaj, IKD gjatë monitorimit ka evidentuar raste të cilat janë kryer shumë më shpejtë se mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve. Në një rast, IKD ka gjetur se gjykatës së shkallës së parë i janë nevojitur rreth 7 muaj për të vendosur në një çështje civile. Në këtë rast, kjo shpejtësi jo e zakonshme e trajtimit të këtij rasti është evidentuar vetëm në gjykatën e shkallës së parë dhe jo në atë të apelit. Kjo pasi kohëzgjatja e trajtimit të këtij rasti nga Gjykata e Apelit përgjithësisht ka qenë e njëjtë me mesataren e përgjithshme të trajtimit të rasteve civile¹³.

Në anën tjetër, IKD ka evidentuar trajtim selektiv të rasteve edhe në kuptim të fillimit të trajtimit të rasteve civile, përkatësisht caktimit të seancës përgatitore në këto raste. Sipas Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore, më së largu 15 ditë pas pranimit të padisë, Gjykata i'a dërgon të paditurit padinë së bashku me shkresat e lëndës për përgjigje në padi¹⁴, derisa brenda 30 ditëve pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata cakton seancën përgatitore¹⁵. Në një rast, IKD ka gjetur se nga data e ngritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës përgatitore kanë kaluar mbi 18 vite¹⁶. Ndërsa, në një rast tjetër, IKD ka gjetur se për caktimin e seancës përgatitore është dashur të kalojnë vetëm rreth 5 muaj nga data e ngritjes së padisë¹⁷.

¹¹ Vendim i Gjykatës së Apelit, numër Ac.nr.1808/18, i datës 10 mars 2021. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/AP_AC_1808_2018_SQ.pdf). (Qasur për herë të fundit më 20 gusht 2022).

¹² Vendimi i Gjykatës së Apelit, numër Ac.nr.101/18, i datës 10 mars 2021. (Shih linkun [AP_AC_101_2018_SQ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/AP_AC_101_2018_SQ.pdf) (gjyqesori-rks.org)). (Qasur për herë të fundit më 20 gusht 2022).

¹³ Vendim i Gjykatës së Apelit, numër Ac.nr.3710/19, i datës 09 shkurt 2021. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/AP_AC_3710_2019_SQ.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10 gusht 2022).

¹⁴ Neni 393 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore,

¹⁵ Po aty, neni 40.4.

¹⁶ Rasti C.nr.995/16.

¹⁷ Rasti C.nr.392/21.

Kjo qasje selektive në trajtimin e këtyre rasteve është aq e theksuar sa nuk mund të arsyetohet me specifikat e rasteve. Një qasje e tillë paraqet dëmtim të veçantë përtej dëmtimit të përgjithshëm të të drejtave të palëve si dhe dëmton imazhin e gjyqësorit në publik.

8. Shpërndarja jo-proporcionale e gjyqtarëve

Në drejtim të qëllimit për ngritje të efikasitetit të trajtimit të rasteve civile dhe uljes së numrit të lëndëve të pazgjdhura, administrimi adekuat i KGJK-së është i domosdoshëm. Në kuadër të këtij administrimi, e një rëndësie të veçantë është shpërndarja proporcionale e gjyqtarëve në gjykata. Kjo i bie që numri i gjyqtarëve të caktuar në gjykata të jetë proporcional si me ngarkesën me lëndë të asaj gjykate ashtu edhe me numrin e banorëve të territorit që mbulon ajo gjykatë.

IKD ka gjetur se një proporcionalitet i kësaj natyre nuk është i shprehur në mes të gjykatave të ndryshme. Në GjTh në Gjakovë gjatë vitit 2021 kanë qenë 4 gjyqtarë të cilët kanë gjykuar lëndë të natyrës civile, në GjTh në Pejë kanë qenë 6 derisa në GjTh në Gjiilan kanë qenë 9 gjyqtarë të tillë. Gjatë vitit 2021, GjTh në Gjiilan ka qenë e ngarkuar me 6632 lëndë, ajo në Pejë me 6495 lëndë derisa ajo në Gjakovë me 4218 lëndë. Nëse e shohim raportin në mes të numrit të gjyqtarëve dhe numrit të lëndëve në puna, atëherë rezulton se në mesatare, një gjyqtar në GjTh në Gjakovë është i ngarkuar me nga 1.064 lëndë, një gjyqtar në GjTh në Pejë është i ngarkuar me nga 1,082 lëndë derisa një gjyqtar në GjTh në Gjiilan është i ngarkuar me nga afërsisht 734 lëndë. Në këtë mënyrë, del se kemi shpërndarje jo-proporcionale të gjyqtarëve në mes të GjTh në Gjakovë dhe Pejë në njërin anë dhe asaj në Gjiilan në anën tjetër.

Nën këto rrethana, KGJK duhet të kujdeset që në drejtim të uljes së numrit të lëndëve të pazgjdhura, ngritjes së efikasitetit dhe drejtshmërisë së trajtimit të rasteve, gjyqtarët të shpërndahen proporcionalisht me ngarkesën me lëndë që ka një gjykate dhe numrin e banorëve të territorit që mbulohet nga një gjykatë e caktuar. Me këtë rast, për të arritur stabilitet me lëndë, KGJK duhet ta shqyrtojë edhe mundësinë e transferimit të gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër, në mënyrë që të ketë shpërndarje proporcionale të gjyqtarëve. Në anën tjetër, KGJK duhet që të ketë edhe planifikim adekuat si në kuptim të pensionimit ashtu edhe në kuptim të rekrutimit të gjyqtarëve, në mënyrë që të garantojë shpërndarje proporcionale të gjyqtarëve na varësi me numrin e lëndëve në punë dhe numrin e banorëve në territorin që mbulohet nga një gjykatë e caktuar.

9. Kundërligjshmëria dhe mos uniformiteti i vendimeve lidhur me tërheqjen e padisë

Neni 423.3 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, **përveçse kur i padituri deklaron** se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”.

Sipas kësaj dispozite, paditësi obligohet që të vie në seancë dhe nëse nuk e bënë këtë, atëherë ndaj të njëjtit ka pasoja procedurale në kuptim të konsiderimit të padisë së tij si e tërhequr. Por, sipas kësaj dispozite, kjo mund të bëhet me një kusht: i padituri të jap pëlqimin për tërheqjen e padisë. Kjo zgjidhje ligjore duket e drejtë në kuptim të faktit se i padituri mund të ketë interes që çështja të vendoset në mënyrë meritore dhe të konsiderohet si çështje e gjykuar, në mënyrë që i njëjti mos të shqetësohet në të ardhmen nga paditësi. Kjo pasi nëse padia konsiderohet e tërhequr, lënda e cila është objekt i padisë nuk konsiderohet si çështje e gjykuar dhe mund të paraqitet sërish në gjykatë.

Por, gjatë monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD ka gjetur raste kur nuk është vepruar në këtë mënyrë nga gjyqtarët. Kjo pasi në disa raste kur paditësit nuk janë paraqitur në seancë, gjyqtarët i kanë konsideruar të tërhequra paditë, përkundër faktit se në seancë nuk ka marrë pjesë edhe i padituri i cili nga gjykata nuk ishte ftuar në mënyrë të rregullt, nga i cili do duhej të merret deklarimi nëse i njëjti dëshiron që të vazhdohet tutje ose jo¹⁸.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur edhe raste të tjera kur nuk është vepruar kështu, por është vepruar në përputhje me nenin 423.3. të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Në këto raste tërheqja e padive është bërë vetëm atëherë kur palët ndërgjyqëse janë thirrur në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen nuk e kanë arsyetuar apo kur i padituri ka qenë prezent në seancë.¹⁹

¹⁸ “Gjykata e Pejës e konsideron të tërhequr padinë e paditësit për vërtetim pronësie”. Betimi për Drejtësi. 3 Dhjetor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-pejes-e-konsideron-te-terhequr-padine-e-paditesit-per-vertetim-pronesie/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022). “Mungojnë palët, konsiderohet e tërhequr padia e paditëses e cila ka kërkuar kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore” Betimi për Drejtësi. 5 Nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-palet-konsiderohet-e-terhequr-padia-e-paditeses-e-cila-ka-kerkuar-kompensimin-e-pagave-jubilarë-dhe-shujtave-ditore/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022). “Mungojnë palët, konsiderohet e tërhequr padia e KEK-ut që nga i padituri kërkonte kompensim dëmi”. Betimi për Drejtësi. 13 Janar 2022 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-palet-konsiderohet-e-terhequr-padia-e-kek-ut-qe-nga-i-padituri-kerkonte-kompensim-demi/>) (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022). “Konsiderohet e tërhequr padia me të cilën paditësi që nga viti 2010 kërkonte kompensimin e dëmit në vlerë rreth 10 mijë euro”. Betimi për Drejtësi. 22 mars 2021 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/konsiderohet-e-terhequr-padia-me-te-cilen-paditesi-qe-nga-viti-2010-kerkonte-kompensimin-e-demit-ne-vlere-rreth-10-mije-euro/>) (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022).

“Mungon paditësi dhe të paditurit, konsiderohet e tërhequr padia për vërtetim pronësie”. Betimi për Drejtësi. 19 Nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-paditesi-dhe-te-paditurit-konsiderohet-e-terhequr-padia-per-vertetim-pronesie/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022). “Mungon përfaqësuesi i paditësit, konsiderohet e tërhequr padia për kompensim dëmi ndaj KEDS-it”. Betimi për Drejtësi. 23 Tetor 2020 (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/mungon-perfaqesuesi-i-paditesit-konsiderohet-e-terhequr-padia-per-kompensim-demi-ndaj-keds-it). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022).

“Mungojnë palët, konsiderohet e tërhequr padia e paditëses e cila ka kërkuar kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-palet-konsiderohet-e-terhequr-padia-e-paditeses-e-cila-ka-kerkuar-kompensimin-e-pagave-jubilarë-dhe-shujtave-ditore/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022).

¹⁹ “Konsiderohet e tërhequr padia në rastin ku kompania e sigurimeve po kërkon kompensimin e dëmit material”. Betimi për Drejtësi. 11 janar 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/konsiderohet-e-terhequr-padia-ne-rastin-ku-kompania-e-sigurimeve-po-kerkon-kompensimin-e-demit-material/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022). “Konsiderohet e tërhequr padia me të cilën paditësi ka kërkuar pagat përcjellëse dhe shpërblimin jubilar nga Komuna e Prishtinës”. Betimi për Drejtësi. 9 Dhjetor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konsiderohet-e-terhequr-padia-me-te-cilen-paditesi-ka-kerkuar-pagat-percjellese-dhe-shperblimin-jubilar-nga-komuna-e-prishtines/>). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022).

“Mungojnë palët paditëse, konsiderohet e tërhequr padia për kompensim dëmi nga Komuna e Prishtinës”. Betimi për Drejtësi. 4 Dhjetor 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-palet>

Në këtë mënyrë, brenda sistemit të drejtësisë, nuk ka një uniformitet lidhur me mënyrën e vendosjes në këto situata. Me këtë rast, IKD rithekson se dispozita duhet të interpretohet drejt në kuptimin e tekstit dhe qëllimit të saj.

Në rastin konkret, IKD vlerëson se gjykata do duhej të vendosin për tërheqje të padisë së paditësit vetëm atëherë kur të gjitha palët në procedurë thirren në mënyrë të rregullt, në mënyrë që të gjithë palët ndërgjyqësore, përfshirë këtu të paditurin, t'i jepet mundësia të realizojnë të drejtat e tyre procedurale konform LPK-së

Nisur nga fakti se lidhur me mënyrën e vendosjes për këtë çështje nuk ka uniformitet në mes të gjyqtarëve, IKD vlerëson se në këtë situatë duhet të ndërhyjë Gjykata Supreme, duke dhënë një mendim juridik lidhur me mënyrën adekuate të vendosjes në këto raste.

paditese-konsiderohet-e-terhequr-padia-per-kompensim-demi-nga-komuna-e-prishtines/). (Qasur për herë të fundit më 27 Qershor 2022).